



Fondi për të Drejtën Humanitare Kosovë
Fond za humanitarno pravo Kosovo
Humanitarian Law Center Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA – KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

	Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS SUDSKI SAVET KOSOVA KOSOVO JUDICIAL COUNCIL		
Nr.Br.No.	01 / 893	
DAT.DT.	17. 11. 2021	
PRISHTINË - A		

MEMORANDUM

NDËRMJET

KËSHILLIT GJYQËSOR TË KOSOVËS

DHE

FONDIN PËR TË DREJTËN HUMANITARE KOSOVË

bien dakord që të zyrtarizojnë marrëveshjen e bashkëpunimit midis këtyre dy institucioneve, pasi që në rend të parë kjo marrëveshje është në dobi të shoqërisë Kosovare, juristëve, studentëve dhe publikut të gjerë.

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i këtij memorandumi është qasja e FDHK në komplet dokumentacionin e rasteve gjyqësore duke filluar nga procedura paraprake deri tek vendimet e formës së prerë, që gjykohen pranë gjykatave të Kosovës në të tria shkallët, në gjykimet për veprat penale: krimet e luftës dhe veprave penale me prapavijë politike dhe etnike në bazë të ligjeve në fuqi.

Neni 2 Obligimet e Gjykatave të Kosovës

Gjykatat zotohen se do t'i mundësojnë monitoruesve të FDHK përcjelljen e gjykimeve të lartpërmendura dhe pajisjen e FDHK me komplet dokumentacionin nga rastet e gjykimeve për krime lufte dhe veprave me prapavijë politike dhe etnike në bazë të ligjit.

Neni 3
Obligimet e Fondit për të Drejtën Humanitare Kosovës

FDHK obligohet që dokumentacionet konfidenciale të pranuar nga këto gjykata të mos i publikon por vetëm ti përdorë për nevojat e tyre të brendshme dhe po ashtu me publikimin e dokumenteve publike obligohet ti redakton emrat e dëshmitarëve, viktimave dhe të dhënat tjera personale të parashikuara me ligj.

Neni 4
Ndryshimet

Çfarëdo ndryshimi në përbërje, synime, objektiva, veprimtari apo afate do të marrë miratimin e ndërsjellë të të dyja palëve nënshkruese. Palët do të përipiqen që të gjitha mosmarrëveshjet t'i i zgjidhnin në bazën e mirëkuptimit të përbashkët dhe në partneritet sa i përket objektit të këtij memorandumi.

Neni 5
Afati

Palët nënshkruese pajtohen që ky Memorandum i Mirëkuptimit të ketë afat prej 15.11.2021 deri më 15.11.2024. me mundësi vazhdimi, nëse palët për këtë pajtohen paraprakisht.

Neni 6
Zgjidhja e konflikteve

Në rast të konfliktit në interpretim të këtij memorandumi, Këshilli Gjyqësor i Kosovës është kompetent për zgjidhjen e konfliktit, respektivisht interpretimin e këtij memorandumi.

Neni 7
Hyrja në fuqi

Ky memorandum mirëkuptimi hyn në fuqi me nënshkrimin e palëve nënshkruese dhe vlen deri në momentin e shkëputjes së tij me pajtimin e palëve ose në mënyrë të njëanshme nga cilado palë nënshkruese me paralajmërim prej tridhjetë (30) ditëve.

Me pajtim të plotë, palët nënshkruese, përmes përfaqësuesve të tyre të autorizuar, e nënshkruajnë këtë memorandum mirëkuptimi.

Nënshkruar në dy kopje

Albert Zogaj,

Kryesues

Këshilli Gjyqësor i Kosovës



Bekim Blakaj

Drejtor

Fondi për të Drejtën Humanitare Kosovë



Nëntor 2021, Prishtinë